



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 274 Prot.

Tiranë, më datë 30.07.2020

VENDIM

Nr. 255, datë 30.07.2020

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 48 dhe neni 134, pika 1, dhe V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë në Këshillin Teknik të raportit të vëzhgimit arkeologjik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 30.07.2020,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Rindërtimi i objektit Shkolla 9 vjeçare “Shaqe Mazreku”, Durrës me aplikues/projektues ARKONSTUDIO dhe zhvillues FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT;
2. Subjekti aplikues duhet të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
3. Subjekti duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje me DRTK Tiranë, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore/monitorojë kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin “Rindërtimi i objektit Shkolla 9 vjeçare “Shaqe Mazreku” si dhe Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, në të cilën do të raportohet raportimi;
4. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, nenet 144-147;
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
6. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR

Arta DOLLANI

Arta
Dollani

Digitally signed by Arta Dollani
DN: cn=Arta Dollani,
Monumenteve të Kulturës,
OU=Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë,
O=Arta Dollani
Date: 2020.07.30 10:59:26 +0200

KRYETAR

Elva MARGARITI

Elva

Margariti

Digitally signed by
Elva Margariti
Date: 2020.07.30
10:59:26 +02'00'